



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. _____ /2026

Dt. 28/07/2026

PROCESVERBAL

Takim koordinues për organizimin dhe mbarëvajtjen e shërbimeve gjatë sezonit të ardhjes së bashkatdhetarëve

Data: 28.07.2026

Vendi: Kabineti i Kryetarit të Komunës së Deçanit

Qëllimi i takimit

Koordinimi i veprimeve dhe angazhimeve institucionale për garantimin e funksionimit të pandërprerë të shërbimeve komunale gjatë sezonit të ardhjes së bashkatdhetarëve dhe rritjes së numrit të vizitorëve në Komunën e Deçanit.

Zhvillimi i takimit

Takimi u udhëhoq nga Kryetari i Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj, i cili theksoi rëndësinë e koordinimit ndërinstitucional dhe të angazhimit të përbashkët për ofrimin e shërbimeve cilësore gjatë kësaj periudhe.

Gjatë takimit u shqyrtua gjendja aktuale në sektorët përkatës dhe u diskutuan masat organizative që duhet të ndërmerren për të siguruar funksionimin normal të shërbimeve publike, administrative, inspektuese, shëndetësore dhe të sigurisë.

U konstatua se institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë përgatitjet e nevojshme dhe janë në gatishmëri të plotë për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve, bashkatdhetarëve dhe vizitorëve, duke garantuar ofrimin e shërbimeve në mënyrë efikase, profesionale dhe në kohë.

Po ashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve për ruajtjen e rendit publik, sigurisë, pastërtisë dhe funksionimit normal të infrastrukturës dhe shërbimeve komunale.

Konkluzionet

- Të vazhdojë koordinimi i rregullt ndërinstitutional gjatë gjithë sezonit të ardhjes së bashkatdhetarëve.
- Të sigurohet funksionimi i pandërprerë i të gjitha shërbimeve komunale dhe institucionale.
- Të merren të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e rendit, sigurisë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët, bashkatdhetarët dhe vizitorët.
- Institucionet përgjegjëse të monitorojnë situatën në terren dhe të reagojnë me kohë ndaj çdo nevoje apo problematike që mund të paraqitet.

Takimi përfundoi me vlerësimin se përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm institutional do të sigurohet një sezon i qetë, i organizuar dhe me shërbime efikase për të gjithë qytetarët, bashkatdhetarët dhe vizitorët e Komunës së Deçanit.

Procesmbajtëse:

Edonë Kameraj

